



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:021007  
Datë: 17.04.2024  
Numri i dokumentit: 05584672

**Ac.nr.2739/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve V.....G....., S..... G....., N..... K....., N..... G....., G..... E....., F..... E..... që të gjithë nga fshati N....., Komuna e Rahovecit, V..... K..... – Sh..... nga fshati H..... e Vogël, Komuna e R....., V..... D....., V..... S..... R....., Z.....G....., B..... B....., Sh..... S..... – B....., F..... S....., M..... K....., që të gjithë nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, B..... B..... –A..... I..... nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati S..... M.....nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor M..... Sh....., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 22,013.15 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.925/2021, të datës 14.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më **17.04.2024** nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pathemeltë** ankesa e të paditurës, Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.925/2021, i datës 14.12.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.925/2021 të datës 14.12.2021 në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar si të themeltë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve V..... G.....S..... G....., N..... K....., N..... G....., G..... E....., F..... E....., V..... K..... – Sh....., V..... D....., V..... S..... – R....., Z..... G....., B..... B....., Sh..... S.....

– B....., F..... S....., M..... K....., B..... B..... – I..... dhe A..... I....., si dhe ka detyruar të paditurën Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t'u paguaj kompensim në emër të ushqimit gjatë punës për në lartësi prej 2,00 euro për një ditë pune, kompensim për shpërblim jubilar si dhe kompensim për shpenzimet e udhëtimit në vlerë prej 70% të vlerës së paguar, si vijon:

- Paditësit të parë **V..... G.....**, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 589 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 1.178,00 euro.
- Paditësit të dytë **S..... G.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 231.12 euro (50 % të pagës bazë prej 462,24 euro), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 587 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.174,00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.405,12 euro
- Paditësit të tretë **N..... K.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 255,01 euro (50 % të pagës bazë prej 510,02 euro), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 589 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.178,00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.433,01 euro.
- Paditësit të katërt **N..... G.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 40 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 730,48 euro (150 % të pagës bazë prej 486,98 euro), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 579 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.158,00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.888,48 euro.
- Paditësit të pestë **G.....E.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 30 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 483,77 euro (100 % të pagës bazë), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 589 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.178,00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.661,77 euro.
- Paditësit të gjashtë **F..... E.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 11 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 136,42 euro (50 % të pagës bazë prej 272,84), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 579 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.158,00 euro përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.294,42 euro
- Paditëses së shtatë **V..... K..... – Sh.....**, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 589 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.178, 00 euro
- Paditëses së tetë **V..... D.....**, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 589 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.178,00 euro.
- Paditëses së nëntë **V..... S..... – R.....**, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 532 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.064,00 euro
- Paditëses së dhjetë **Z..... G.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 30 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 496,32 euro (100 % të pagës bazë), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 575 ditë pune, në

vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.150,00 euro përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.646,32 euro.

- Paditëses së njëmbëdhjetë **B..... B.....**, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 579 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.158,00 euro
- Paditëses së dymbëdhjetë **Sh..... S..... – B.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 227,10 euro (50 % të pagës bazë prej 454,20 euro), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 588 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.176,00 euro përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.403,10 euro.
- Paditëses së trembëdhjetë **F..... S.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 20 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 354,76 euro (75 % të pagës bazë prej 473,01 euro), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 589 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.178,00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.532,76 euro.
- Paditësit të katërmbëdhjetë **M..... K.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 20 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 357,61 euro (75 % të pagës bazë prej 476,81 euro), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 589 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 1.178,00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.535,61 euro
- Paditëses së pesëmbëdhjetë **B..... B..... – I.....**, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 360 ditë pune, në vlerë prej 2,00 euro për një ditë pune, shumën prej 720,00 euro, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për vajtje ardhje nga shtëpia në punë si dhe anasjelltas, sipas çmimit të biletës prej 1,40 euro në dy drejtime ti paguaj shumën prej 352,80 euro ( 70 % i 1,40 € = 0,98 € x 360 ditë pune = 352,80 euro), përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.072,80 euro.
- Paditësit të gjashtëmbëdhjetë **A..... I.....**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punë ti paguaj shumën prej 225,76 euro (50 % të pagës bazë prej 451,52 euro), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për gjithsejtë 579 ditë pune, në vlerë prej 2,00 për një ditë pune, shumën prej 1.158,00 përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.383,76 euro, si dhe për të gjithë paditësit shumën e përgjithshme prej gjithsejtë 22.013,15 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga prej ditës së paraqitjes së padisë (31.12.2019), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, **SI ME BAZË**.

Në pikën e tretë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 2.080,20 euro me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar ashtu

që ta refuzojë si të pa themeltë kërkesëpadinë e paditësve apo ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësit kanë ushtruar përgjegjje në ankesë, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet Aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, Sefer Morina, avokat nga Prizreni, me datë 31.12.2019 kanë ushtruar padi për kompensim në emër të shpërblimit jubilar, kompensimin e shujtave ditore për ditët e pranisë në punë dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit

E paditura, në përgjegjje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë dhe precizimin e kërkesëpadisë si të pathemeltë me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv duke marrë për bazë se kontrata kolektive është nënshkruar nga organi i nivelit qendror nga MASHT dhe SBASHK ndërsa e paditura nuk ka qenë nënshkruar e kësaj kontrate si nivel lokal kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 2 i Ligjit të Punës me të cilin është paraparë që kontrata kolektive mund të lidhet në tri nivele. E paditura mendon që paditësit duke marrë parasysh faktin se i mungon legjitimiteti pasiv është dashur që kërkesëpadinë ta drejtoj edhe ndaj Ministrisë së Arsimit si nënshkruar të kontratës në fjalë. Mbrojtja e të paditurës është në përputhje me përgjigjen nga DKA- ja me të cilën në parim nuk është kundër të drejtave të mësimdhënësve në bazë të dispozitave të kësaj kontrate që kanë implikime financiare por që në mungesë të mjeteve të alokuara në kuptim të dispozitave të nenit 46 të kësaj kontrate e njëjta ka mbetur e pazbatuar. Mbrojtja e të paditurës mbetet në qëndrimin ngase kontrata kolektive është nënshkruar në mes të MASHT dhe SBASHK dhe ashtu siç konstaton edhe Gjykata Kushtetuese në rastin numër KO139/18 se kjo kontratë reflekton vullnetin reciprok në mes të dy palëve nënshkruar. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Punës respektivisht me asnjë dispozitë të këtij ligji nuk është paraparë e drejta e punëtorit të pensionuar apo në marrëdhënie pune në realizimin e të drejtës për pagesën e pagës përcjellëse, shpërblimit jubilar apo shpenzimeve të rrugës, të ushqimit si në kërkesëpadinë e paditësve, konsiderojmë se paditësit nuk kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë administrative për të realizuar interesin e tyre juridik në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të ligjit numër 06/L-114 për zyrtarët publik. Në bazë të nenit 4 të Ligjit për Shërbimin Civil që ka qenë në fuqi deri më 09.07.2020 pozita e drejtorit të shkollës, e sekretarit, e sigurimit të shkollës, pozita e pastruesit dhe punëtorët ndihmës nuk konsiderohen punëtorë të arsimit kjo edhe në bazë të interpretimit që ka bërë Zyra për Personel e të paditurës. Sa i përket buxhetimit të mjeteve lidhur me kërkesëpadinë e paditësve e paditura në përgjigje në padi ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e alokimit të buxhetit për nivelin lokal siç është e paditura këtu, theksojmë se në bazë të qarkoreve buxhetore të Ministrisë së Financave për vitin 2019, 2020 dhe 2021 në asnjë nga këto qarkore të cilat konsiderohen dokumente bazë për

krijimin e buxhetit vjetor, nuk është paraparë respektivisht nuk është alokuar asnjë mjet financiar për kompensimin e ushqimit apo të udhëtimit. Për vitin 2019 komunës së Rahovecit janë alokuar mjetet në shumën prej 22.967,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse, kjo në bazë të kalkulatorit sipas pikës 2.2 të kësaj qarkore. Në vitin 2020 komunës së Rahovecit i janë alokuar 46.643,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit, ndërsa për vitin 2021 në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit janë ndarë gjithsej 42.150,00 Euro dhe për herë të parë janë ndarë 27.169,00 Euro në emër të pagave jubilarë sipas kontratës kolektive andaj përtej kësaj që është paraparë në Ligjin për Buxhetin e RKS-së dhe ndarjes buxhetore, e paditura nuk ka kompetencë ligjore për të kryer pagesat tjera në emër të kompensimeve sipas kontratës kolektive të arsimit para universitar. Rrjedhimisht për të gjitha vitet sipas kërkesës për kompensimin e ushqimit dhe udhëtimit janë përtej mundësive ligjore për të kryer pagesa sipas kërkesëpadisë së paditësve. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të bazës juridike në të cilën thirret padia dhe kërkesëpadija e paditësve e që është kontrata kolektive e arsimit padyshim se mund të konkludohet se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv për shkak se nuk është nënshkruese e kontratës kolektive të arsimit në nivel të komunës siç parasheh ligji i punës për nënshkrimin e kontratave në tri nivele, në nivel vendi, në nivel dege dhe në nivel të ndërmarrjes. Për të zbatuar dispozitat që kanë implikime financiare të kontratës kolektive, në të njëjtën janë paraparë dispozitat e nenit 46 të kontratës kolektive për mënyrën e sigurimit të mjeteve financiare dhe alokimin e të njëjtave të nivelit lokal në vijë të veçantë buxhetore për të kryer obligimet sipas nenit 35 paragrafi 5,7 dhe 9 të kontratës kolektive. Këtyre dispozitave nuk i janë përmbajtur nënshkruesit e kontratës kolektive që janë MASHT-i dhe SBASHK-u. Konsiderojmë që parashtrësja për zgjerimin e padisë dhe parashtrësja për precizimin e kërkesëpadisë kanë qenë të panevojshme duke marrë parasysh se të gjitha provat e bashkangjitura me këto parashtrësja kanë qenë në dispozicion që nga momenti i parashtrimit të padisë në gjykatë. Propozimi i palës së paditur për bashkimin e lëndëve me bazë të njëjtë juridike e që është kontrata kolektive e arsimit ka të bëjë me të gjitha paditë që gjykata i ka pranuar nga paditësit të një shkolle të caktuar. Andaj aprovimi i kërkesëpadisë së paditësve cenon rëndë sigurinë juridike të Komunës së Rahovecit si palë e vetme e paditur. Mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pa bazë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.925/2021 të datës 14.12.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë si të themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësit ishin në marrëdhënie pune tek e paditura. Nga vërtetimi për ditët e pranisë në punë me numër 218/2021 të datës 19.02.2021, u konstatua fakti se paditësi V..... G..... ka gjithsejtë 589 ditë pune. Nga vërtetimi për ditët e pranisë në punë me numër 217/2021 të datës 19.02.2021, u konstatua se paditësi S..... G..... ka gjithsejtë 587 ditë pune, ndërsa nga vërtetimi me numër 157/1 të datës 06.11.2019, u konstatua fakti se paditësi S.....G..... ka gjithsejtë mbi 10 vite përvojë pune. Nga vërtetimi numër 211/2021 të datës 19.02.2021 për ditët e pranisë në punë u konstatua se paditës N..... K.....ka gjithsejtë 589 ditë pune, ndërsa nga vërtetimi mbi përvojën e punës me numër 156/1 të datës 06.11.2019,

vërtetohet se paditësi N..... K.....ka gjithsejtë mbi 10 vite përvojë pune. Nga vërtetimi numër 210/2021 të datës 19.02.2021 për ditët e prezencës në punë për paditësin N..... G....., vërtetohet se i njeti ka gjithsejtë 579 ditë pune. Nga vërtetimi mbi përvojën e punës me numër 155/1 të datës 06.11.2019, vërtetohet se paditësi N..... G..... ka gjithsejtë mbi 40 vite përvojë pune. Nga vërtetimi numër 219/2021 të datës 19.02.2021, për ditët e pranisë në punë konstatohet se paditësi G..... E..... ka gjithsejtë 589 ditë pune. Nga vërtetimi me numër 225/2021 të datës 19.02.2021, konstatohet se paditësi F..... E..... ka gjithsejtë 579 ditë pune, ndërsa nga vërtetimi numër 153/1 të datës 06.11.2019, konstatohet se paditësi F..... E..... ka gjithsejtë mbi 11 vite përvojë pune. Nga vërtetimit me numër 220/2021 të datës 19.02.2021 për paditësen V.....K..... – Sh.....k..... se e njëjta ka gjithsejtë 589 ditë pune. Nga vërtetimi numër 221/2021 të datës 19.02.2021 për ditët e pranisë në punë për paditësen V..... D..... konstatohet se e njëjta ka gjithsejtë 589 ditë pune. Nga vërtetimi me numër 224/2021 të datës 19.02.2021, vërtetohet se paditësja V..... S..... – R..... ka gjithsejtë 532 ditë pune. Nga vërtetimit me numër 212/2021 të datës 19.02.2021, vërtetohet se paditësja Z..... G.....ka gjithsejtë 575 ditë pune, ndërsa nga vërtetimi me numër 163/1 të datës 06.11.2019, vërtetohet se paditësja Z..... G.....ka gjithsejtë mbi 30 vite përvojë pune. Nga vërtetimi numër 223/2021 të datës 19.02.2021 për ditët e pranisë në punë, vërtetohet se paditësja B..... B..... ka gjithsejtë 579 ditë pune. Nga vërtetimit numër 215/21 të datës 19.02.2021, vërtetohet se paditësja Sh..... S..... – B..... ka gjithsejtë 588 ditë pune, ndërsa nga vërtetimi mbi përvojën e punës 158/1 të datës 06.11.2019, vërtetohet se paditësja Sh..... S..... – B..... ka gjithsejtë mbi 10 vite përvojë pune. Nga vërtetimi numër 214/2021 të datës 19.02.2021, vërtetohet se paditësja F..... S..... ka gjithsejtë 589 ditë pune, ndërsa nga vërtetimi mbi përvojën e punës me numër 152/1 të datës 06.11.2019, vërtetohet se paditësja F..... S..... ka gjithsejtë mbi 30 vite përvojë pune. Nga vërtetimi numër 213/2021 të datës 19.02.2021, vërtetohet se paditësi M..... K..... ka gjithsejtë 589 ditë pune. Nga vërtetimi numër 163/1 të datës 06.11.2019, vërtetohet se paditësi M.....K..... ka gjithsejtë mbi 20 vite përvojë pune. Nga vërtetimi numër 216/2021 të datës 19.02.2021, vërtetohet se paditësja Borëbardha Berisha – I... ka gjithsejtë 360 ditë pune. Nga vërtetimi i lëshuar nga SH.T.U, vërtetohet se çmimi i biletës në relacionin Rahovec – Nagavc kushton 1,40 euro në të dy drejtimet. Nga vërtetimi numër 222/2021 të datës 19.02.2021, vërtetohet se paditësi A..... I..... ka gjithsejtë 579 ditë pune. Nga vërtetimi mbi përvojën e punës me numër 149/1 të datës 06.11.2019, vërtetohet se paditësi A..... I..... ka gjithsejtë mbi 10 vite përvojë pune. Bazuar në provat e administruara, gjykata e aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke e mbështet vendimin e saj në nenin 35 paragrafi 5 paragrafi 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017.Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së, ndërsa për sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata vendosi sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtëhënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk është nënshkruar nga Komuna e Rahovecit si autoritet i veçantë dhe se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Gjykata e Apelit konsideron se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve të arsimit ku sipas nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i kësaj kontratë "1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate

*Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.*

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadija duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruesit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Gjykata e Apelit, po ashtu e ka vlerësuar pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se paditësit nuk i kanë shtjerr mjetet e brendshme për realizimin e të drejtave të saj në afatin e paraparë ligjor, dhe gjeti se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar për faktin se e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësit brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, dhe kjo asesi nuk nënkupton se paditësja nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura ashtu siç pretendon e paditura, përkundrazi, e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditëses në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadiisë së paditëses që në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe në emër të kompensimit shpërblimit jubilar t'ia kompensojë shumat e aprovuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.



Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.2739/2022, datë 17.04.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,**  
**Ardian Ajvazi**